



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË INFRASTRUKTURËS

---

## Raporti teknik

**Objekti : “Shërbimi i pastrimit,zona perëndimore”**

**Burimi i financimit : Buxheti i Bashkisë miratur me VKB Nr.71 datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023 – 2025 të Bashkisë Shkodër”.**

**Fondi Total : 109,199,665.87 lekë me TVSH**

**Afati i realizimit : 36 muaj**

**Vendodhja: Njësitë Administrative Velipoje, Dajc, Berdice, Ana Malit dhe plazhi i Velipojës.**

### Gjendja aktuale.

Aktualisht shërbimi i pastrimit në zonën Perëndimore realizohet me sipërmarrës privat me një kontratë tre vjecare që përfundon me 29 qershor 2023. Shërbimi i pastrimit të zonës perëndimore është realizuar në dy zona shërbimi në zonën 2 dhe në zonën 4. Zona 2 përfaqëson njësitë administrative Velipoje, Dajc, Berdice, Ana Malit , ndërsa zona 4 shërbimin e pastrimit për zonën e plazhit të velipojës në sezonin turistik. Zërat e shërbimit deri në fund të qershorit 2023 konsistojnë në realizimin e shërbimeve si më poshtë :

- Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve,
- dezinfektimi i pgm`ve;
- Mirembajtja e kazaneve dhe pastrimi I sipërfaqes përreth pikës së grumbullimit;
- Depozitimi në lëndfill;
- Zona:4 me shërbimin grumbullim dhe transport e depozitim, dezinfektim mirëmbajtje konteneirësh dhe shërbime të mirmbajtjes të rërës, fshirje manuale dhe mirmbajtje tualete publike.

### Objektivi

Objektivi kryesor për Bashkinë Shkodër, është përmirësimi i cilësisë së shërbimit të pastrimit së zonës perëndimore në njësitë Ana e Malit Bërdicë, Dajc dhe Velipojë dhe kryesisht në plazhin e Velipojës, me rritjen e performances në grumbullimin, transportin dhe depozitim e sigurtë të mbetjeve në lëndfillin e Bushatit. Zona Perëndimore do të jetë e ndarë në tre zona shërbimi. Në zonën 1, përlogaritet shërbimi i pastrimit i njësive administrative të zonës perëndimore dhe zona 2 dhe 3 është caktuar zona e plazhit tashmë me një sezon prej 110 ditësh. Zona e plazhit është përcaktuar si një zonë ku do të ketë dy skema të vecanta të grumbullimit të mbeturinave në atë me konteneirë dhe në mbledhjen derë më derë. Risia që vjen për zonën e plazhit, do të përmirësojë dukshëm shërbimin e pastrimit ,do të ulë volumin e mbetjeve nëpër konteneirë, dhe do të rrisë pastërtinë e plazhit të velipojës, duke e bërë këtë territor një destinacion më atraktiv për turistët e huaj dhe vendas.